



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 5339 / Prot.

Tiranë, më 30.08.2024

Lënda: Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2024-2025.

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga "Aleksandër Moisiu"
Tiranë

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar, Urdhrit nr. 100, datë 25.02.2022, "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar dhe shkresës nr. 2319/1 prot., datë 04.04.2024, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, "Për praktikën profesionale", Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, zhvillojnë procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Profili ku kandidati do të kryejë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit lidhet me programin e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë që ka përfunduar kandidati.

Për vitin shkollor 2024-2025 aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesisë do të kryhet nëpërmjet platformës e-albania.

Kandidatët kanë të drejtë të zhvillojnë praktikën profesionale në një nga tri periudhat mësimore.

Afati i regjistrimit të kandidatëve që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, nëpërmjet platformës e-albania:

- në periudhën e parë mësimore është nga data 26.08.2024-05.09.2024;
- në periudhën e dytë mësimore është nga data 02.12.2024-13.12.2024;

- në periudhën e tretë mësimore është nga data 03.03.2025-14.03.2025.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, 7 (shtatë) ditë pas mbylljes së aplikimit të secilës periudhë, dërgon në format excel, në DRAP-in përkatës, listën e praktikantëve të periudhës përkatëse sipas tabelës bashkëlidhur shkresës.

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar, 7 (shtatë) ditë pas marrjes së listave nga ZVAP-i nën juridiksionin e saj, harton listën përfundimtare me kandidatët aplikantë të periudhës përkatëse, në format excel dhe ja dërgon Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, 7 (shtatë) ditë pas marrjes së listave nga DRAP-et, dërgon listat përfundimtare të kandidatëve të periudhës përkatëse, zyrtarisht me postë dhe në rrugë elektronike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, publikojnë në faqet zyrtare të internetit, listën e IAPP-ve, publike dhe/ose private, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale, në të tri fazat e aplikimit.

Praktikanti paraqitet në IAPP për të filluar praktikën profesionale, në periudhën që ka aplikuar pas pranimi dhe lajmërimit nga ZVAP.

ZVAP-et janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të pasqyruara në tabelën e dërguar në DRAP-e, si dhe për respektimin me rigorozitet të kërkesave dhe të afateve të përcaktuara si më sipër.

Procesi i organizimit dhe zhvillimit të praktikës profesionale është objekt monitorimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

